



Syri i Vizionit

OJQ Syri i Vizionit
Isa Demaj 14
30000 Pejë
Kosovë

T: 039 423 240
E: info@syriivizionit.org
W: www.syriivizionit.org



National Democratic Institute
Andrea Gropa 1
10000 Prishtinë
Kosovë

T: 038 220 765
W: www.ndi.org/kosovo

Monitorimi i zbatimit të ligjit

Organizata joqeveritare “Syri i Vizionit” mbështetur nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), që nga muaji nëntor 2011, është duke monitoruar zbatimin e këtij ligji në praktikë, duke mbajtur tryeza dhe takime me institucione të ndryshme në nivel lokal dhe qendror.

Përmes këtij projekti do të krijohet një perceptim i drejtë se sa është duke u bërë zbatimi i këtij ligji në terren, se a janë nxjerrë udhëzimet e duhura administrative në përputhje me këtë ligj dhe sa janë harmonizuar ato me përmbajtjen e ligjit.


Në punën dhe aktivitetet që Syri i Vizionit është duke bërë janë të përfshirë gjithë akterët që janë përgjegjës në zbatueshmërinë e ligjit për Mbrojtje të Natyrës. Në fund të muajit prill 2012 kur edhe do të përfundojë projekti, Syri i Vizionit, do të publikojë raportin vlerësues mbi zbatimin e këtij ligji në praktikë, raport ky që do të ju dorëzohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor.



Syri i Vizionit

LIGJI PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Nr. 03/L-233



LIGJI PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Lënda

1

Me këtë ligj rregullohet sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës dhe vlerave të saj.

2

Natyra në kuptim të këtij ligji paraqet gjithë larminë biologjike dhe peizazhore.

Qëllimi

Ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht:

- 1.1. mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
- 1.2. përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- 1.3. vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;
- 1.4. pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre;
- 1.5. sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;
- 1.6. sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- 1.7. parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridikë dhe fizikë në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;
- 1.8. mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së;
- 1.9. ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve të cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

Zbatimi

1. Ky ligj zbatohet në Republikën e Kosovës për të gjithë personat juridik, fizik dhe institucionet të cilat janë bartës i të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga ky ligj.
2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në rastet e evitimit të rrezikut të drejtpërdrejt për jetën, shëndetin e njeriut apo pasurisë, shpëtimit të njerëzve ose pasurisë si dhe kryerjes së aktiviteteve për mbrojtjen e Republikës së Kosovës.
3. Dispozitat nga paragrafi 2. i këtij neni, zbatohen vetëm gjatë kohës, sa zgjasin rrethanat e cituara.

Interesi i përgjithshëm për mbrojtjen e natyrës

Natyra dhe vlerat e trashëgimisë natyrore janë me interes për Republikën e Kosovës dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë.

